

09.03.2021



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISE	
MINISTARSTVO EKONOMIJE	
MINISTRY OF ECONOMY	
Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit	02
Nr. Prof. Br. Prof.	1260
Nr. i faqeve Broj strana No. pages	3
Datum: Date:	17.05.2021
PRISTINE A	
NO. 1	

02-035/02-449

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

Në bazë Ligjit Nr. 03/L-189 mbi Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr 82, 21 tetor 2010) dhe Nenin 13 të Rregullores MF – Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, lidhet kjo;

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

në mes të

MINISTRIA E EKONOMISË
dhe

Komunës së Vitisë

Për transferin e pasurisë jo-financiare;

Ministria e Ekonomisë (në tekstin e mëtejme ME) dhe Komuna e Vitisë (në tekstin e mëtejme: Përfituesi), janë pajtuar për transferin e pasurisë jofinanciare: **Lloti V "Auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje tjera të obligueshme -Programi mbështetës-Zbatimi i masave të Eficiencës së Energjisë në objektet publike (V)"**

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1. Projekti: "Auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje tjera të obligueshme - Programi mbështetës-Zbatimi i masave të Eficiencës së Energjisë në objektet publike (V)"- me numër identifikues 213/019/025/521, i implementuar në vitin 2020 në shkollën "Mirali Sejdiu" Goshicë – Viti.

1.1. Vlera e financimit në këtë shkollë është, 69,939.80 Euro.

Neni 2

Përgjegjësitë e palëve

1. Përfituesi merr në pronësi pasurinë jo-financiare nga Neni 1 i kësaj Marrëveshje.
2. ME, me qëllim të zbatimit të rekomandimit nga auditimet e energjisë, dizajni dhe specifikacioni teknik ka zbatuar masat për efikasitetin e energjisë, duke financuar dhe perfunduar projektin nga neni 1, e financuar dhe cilesuar si Pasuri kapitale e Qeverisë së Republikës së Kosovës..
3. ME, ruan të drejtën e shfrytëzimit të të dhënave nga zbatimi i rekomandimeve të projektit nga Neni 1, (në tekstin e mëtejshëm: Objekti i Marrëveshjes)

Neni 3

Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projektit

1. Përfituesi merr në pronësi dhe menaxhim të plotë dhe pa kurrfarë kufizimesh pasurinë jo-financiare nga Objekti i Marrëveshjes (Secila pjesë e vet nga Neni 1, pika 2 e marrëveshjes).
2. Përfituesi miremban dhe bartet të gjitha obligimet tjera që mund të dalin për funksionimin e rregullt të projektit nga objekti i marrëveshjes, si sistemin e ngrohjes dhe pajisje tjera të instaluar në kuadër të projektit.
3. Përfituesi (pjesë shtesë të këtij dokumenti) do ta ketë në pronësi të gjithë dokumentacionin që bën të formalizuar projektin nga Objekti i Marrëveshjes;

3.1. Kontratat.

3.2. Faturat e projektit.

3.3. Projekti i zbatimit.

3.4. Procesverbali i pranimi të situacioneve sipas implementimit të projektit në objekte.

3.5. Urdhër-pagesa.

Neni 4

Gjendja teknike e projektit

ME i derzon përfituesit projektin nga Neni 1 pika 2 e kësaj marrëveshje, në gjendje të rregullt teknike dhe sipas standardeve të paraqitura në projektin detaj dhe specifikacioni teknik. Të gjitha këto janë të vertetuara nga Menaxheri për mbikëqyrjen e kontratës dhe Komisioni për pranimin teknik të punëve.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët bëjnë përpjekjen për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që kanë ndërmjet veti përmes mirëbesimit ose bisedimeve të përbashkëta. Në rast të ndonjë mospajtimi, kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes, duke përfshirë esencën e saj, vlefshmërinë apo përfundimin do të zgjidhet nga Gjykata kompetente në Prishtinë

Neni 6

Hyrja në fuqi


Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje të zbatohet nga dita e nënshkrimit të saj.


Në emër të:

Në emër të:

Ministrit së Ekonomisë

Komuna / Viti


Fatos Qerimi, Sekretar i Përgjithshëm


Sokol Haliti - Kryetar

Prishtinë;

Data e nënshkrimit; 17 / 5 / 2021